



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:084568

Datë: 19.10.2023

Numri i dokumentit: 04806026

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.318/21

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Qendresa Sadrijaj, në çështjen penale kundër të pandehurit S. K. , për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor”, nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.659/21 e datës 22.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 16.10.2023, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorian Juniku dhe të pandehurit S. K. , të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 18.10.2023, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

S. K. , i lindur me, në Pejë me banim në Rr. ”M. Z.” nr. 34 Pejë, i biri i S. dhe i nënës S., e gjinisë G., identifikohet në bazë të letërnjoftimit me numër personal ..., Student, i pa martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 13.03.2021 rreth orës 23:35 në Rr. W. C., Nr. 52 në Pejë, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet të dëmtuarit T. L.në atë mënyrë që: gjersa i dëmtuari ishte duke u kthyer nga puna në shtëpi dhe posa e parkon veturën e tij në një parking privat para shtëpisë së tij në rrugën e lartcekur dhe posa del nga vetura papritmas i pandehuri S. K. e godet të dëmtuarin- T. me grushte në fytyrë, kokë dhe në trup duke e rrëzuar

për toke me ç 'rast i shkakton të dëmtuarit T. L.lëndime të' lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet, dhe atë: Gjak mbledhje nen lëkurorë përreth syrit të' djathtë gërvishtje në regjionin ballor të kokës, në bërryl dhe në shuplakën e dorës së majtë të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme në shëndet si në Akt ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F. B. të datës 07.04.2021 nr. të shkaktuara liga veprimi mekanik i mjetit te fortë.

- me çka ka kryer veprën penale "Lëndim i lehtë trupor" nga Neni 185 par. 1 nën-par, 1.4 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

- I. DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 € (treqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar i pandehuri që ta paguaj në afat prej 3 muajsh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- II. Në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- III. I dëmtuari T. L.me adresë në Rr. "W. C.", nr. ..., në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko- civil.
- IV. OBLIGOHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

ARSYETIM

- A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 22.04.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.659/2021, kundër të pandehurit S. K. , për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor”, nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 14.07.2023, ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën i pandehuri ka propozuar që çështja të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, propozim të cilin nuk e ka kundërshtuar as prokurori i shtetit.

Gjykata me aktvendim procedural e ka aprovuar propozimin e të pandehurit për referim të rastit në procedurën e ndërmjetësimit e duke vepruar konform nenit 229 par.1 të KPPRK-së, ku parashihet se: “ ... për një vepër të dënueshme me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet ose me gjobë dhe burgim deri në tri (3) vjet, për ndërmjetësim...”, e meqë vepra që i vihet në barrë të pandehurit është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet. Mirëpo, në procedurën e ndërmjetësimit me numër reference Nr. ...23, të datës 07.08.2023, është përpiluar raporti për mos fillimin e procedurës së ndërmjetësimit. Pas kësaj, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.10.2023, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Dorian Juniku dhe i pandehuri S. K. , ndërsa nuk ka prezantuar i dëmtuari T. L., i ftuar në mënyrë të rregullt. Në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit e në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovojë pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi: “Meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe atë Konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, i cili e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëri vullnetarisht dhe në mbështetje në faktet e çështjes që përmban aktakuza, andaj nga Gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj si pas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rasatin përcaktimet ët llojit dhe lartësisë së d dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese”.

I pandehuri deklaroi: “Më vjen shumë keq për këtë rast që ka ndodhë, është diçka e kaluar i kam shpreh keqardhje gjykatës dhe palës së dëmtuar”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata në lidhje me të pandehurin rrethanat rënduese që parashihen në nenin 70 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, është dashja e lartë e të pandehurit në kryerjen e veprës penale përderisa si rrethanë lehtësuese mori rrethanën konform nenin 70 par.3 pika 3.10 të KPRK-së, pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë të shoqëruar me kërkim falje, andaj duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 43 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë që për këtë veprë penale të shqiptohet dënim gjorbë ose me burgim deri në tri (3) vjet, që konsiston në dënim alternativ, pra mund t’ ia shqiptojë të pandehurin njërin nga dënimet e parapara e në këtë rast gjykata pas analizimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave ka vendosur që të akuzuarit t’ i shqiptojë dënim me gjorbë në lartësi prej 300 euro brenda kufijve ligjor të lartësisë së gjorbës, duke vepruar konform nenit 43 par.1 të KPRK-së, ku parashihet se: “Dënimi me gjorbë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane (në tekstin e mëtejme “EURO”). Dënimi me gjorbë nuk mund të tejkalojë njëzet e pesëmijë (25.000) Euro, ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro”, e konform rrethanave të vlerësuara e të cekura si më lartë dhe duke pas parasysh se në cilësimin juridike të veprës dhe elementeve të saj nuk është cekur minimumi dhe maksimumi i lartësisë së gjorbës, lartësinë e dënimit me gjorbë të shqiptuar ndaj të pandehurit e konsideron të drejtë e në harmoni me veprimet e tij. Po, ashtu lidhur me paralajmërimin e të pandehurit në rast të mos pagesës së gjorbës gjykata e bëri konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, ku thuhet se: “ Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjorbën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjorbë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjorbë zëvendësohet me dënimin me burgim,

njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet”.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit S. K. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil u mor konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.318/21, me datë 18.10.2023

Bashkëpunëtorja profesionale:

Qendresa Sadrijaj

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.